OZAL PRESS

E PREMTE,
21 NËNTOR 2025

ÇFARË DO TË PËRFSHIHET?

Turgut Ozal, aty ku dita është një mundësi

Intervista brenda dhe jashtë shkollës

Tregime të shkurtra dhe ilustrime nga nxënësit

RUBRIKAT

01. PËRSHKRIMI I GAZETËS

"Mirë se erdhët në Ozal Press"

02. LAJME & AKTUALITET

"Jeta në Shkollën Turgut Ozal"

03. INTERVISTA BRENDA SHKOLLËS

Fytyra të Njohura të Ozalit

04. INTERVISTA ME NJERËZ TË FAMSHËM

"Yjet në Fokus"

05. KËNDI KREATIV

Përfshihen: talente, poezi, piktura, shkrime

06. KËNDI I KULTURËS

Artikuj për libra, filma, muzikë, art, shfaqje teatrale, etj.

07. A E DINIT SE...

Përfshihen informacione interesante

09 KËNDI GAZMOR

Fjalëkryqe & shaka

08. KËNDI SPORTIV

Këndi Sportiv sjell ndeshjet kryesore dhe lajmet më të rëndësishme të muajit.

MIRË SE ERDHËT NË OZAL PRESS

PSE OZAL PRESS ?

Shumë herë, në shkollën tonë, dëgjohet vetëm “Turgut, Turgut” kur flasim për shkollën. Por ne donim një emër pak më të veçantë për gazetën, që të tregonte lidhjen me shkollën dhe identitetin tonë si nxënës. Kështu lindi ideja për “Ozal Press”.

Ky emër tregon se kjo është gazeta jonë, zëri ynë, një vend ku mendimet, idetë dhe historitë tona kanë vend. “Ozal” na kujton shkollën, ndërsa “Press” tregon qartë se kjo është hapësira ku ne shkruajmë dhe ndajmë gjithçka që na intereson.

SI LINDI OZAL PRESS

Gjithçka filloi nga një mendim i thjeshtë: si mund t’i shprehnim më mirë zërat tanë si nxënës. Shpesh kishim ide, mendime dhe përvoja që donim t’i ndanim me të tjerët, por na mungonte një vend ku të mund ta bënim këtë. Atëherë thamë: “Pse të mos hapim një gazetë shkollore?”

Kështu lindi ideja jonë e një gazetë që do të jetë hapësira ku çdo nxënës mund të shkruajë, të ndajë mendimet e veta dhe të tregojë historitë e shkollës sonë. Nëpërmjet saj do të flasim për aktivitetet që zhvillojmë, për arritjet tona dhe për ngjarjet që na frymëzojnë çdo ditë.

Por jo vetëm kaq! Në gazetën tonë do të gjeni edhe intervista me të ftuarit e njohur që vijnë në shkollë për seminare e takime motivuese. Do të përpiqemi t’i njohim më mirë, t’u bëjmë pyetje që na ndihmojnë të mësojmë dhe të frymëzohemi prej tyre.

Gazeta jonë është më shumë se një projekt, është zëri i nxënësve dhe pasqyra e jetës në shkollën tonë.

JETA NË SHKOLLËN TURGUT OZAL

Lajme & Aktualitet

Finalja e Madhe e Debatit – një përballje që ndezi skenën e mendimit!
Pas disa javësh përballjeje të zjarrta idesh, u zhvillua Finalja e Debatit, në kuadër të Muajit të Artit dhe të Letërsisë.
Klasat XII-E dhe XII-G sollën një sfidë plot pasion, bashkëpunim dhe mendim kritik.
Publiku përjetoi çdo moment me emocion, ndërsa juria e pati të vështirë të zgjidhte fituesin.
Trofeun e këtij konkursi e ngriti klasa XII-G!
Urime për fitoren dhe për të gjithë nxënësit pjesëmarrës që e shndërruan këtë aktivitet në një manifestim të vërtetë të fjalës dhe mendimit!

Takimi i parë i Senatit të Shkollës!
Fillimi i një viti plot ide, bashkëpunim dhe energji pozitive nga senatoret tanë!
Gati për të sjellë ndryshime të bukura dhe për ta bërë zërin e nxënësve të dëgjohet më shumë se kurrë!

ASEF është një konkurs i rëndësishëm shkencor që ka nisur në vitin 2007 me disa projekte dhe sot është shndërruar në një garë kombëtare që nxit kreativitetin dhe kërkimin shkencor. Gjatë viteve 2019–2021, në të kanë marrë pjesë mbi 1000 projekte çdo vit, duke treguar rritjen e madhe të këtij aktiviteti.

Në edicionin e 19-të, shkolla jonë mori pjesë me 79 projekte dhe arriti rezultate të shkëlqyera: 12 medalje Gold, 21 Silver dhe 25 Bronz. Këto arritje pasqyrojnë punën dhe përkushtimin e nxënësve, si dhe mbështetjen e mësuesve mentorë. ASEF mbetet një mundësi e vlefshme për të gjithë të rinjtë që duan të zhvillojnë ide shkencore dhe inovative.

FYTYRA TË NJOHURA TË OZALIT

Këtu do të mësoni rreth Intervistave brenda shkollës

Intervistat e këtij muaji

Këtë muaj, stafi i gazetës ka realizuar dy intervista të veçanta me figura të rëndësishme të shkollës sonë.

Me nëndrejtoreshën Sonila Shehu, intervista është zhvilluar në formë video dhe është publikuar në YouTube; në website-in e shkollës do të gjeni linkun për ta parë të plotë. Ajo flet për rolin e saj si mbikëqyrëse e gazetës dhe për rëndësinë e përfshirjes së nxënësve në aktivitete krijuese.

Ndërsa intervista me mësuesen e gjuhës, znj. Flora Collaku, është realizuar me shkrim, ku ajo ndan mendimet e saj për gjuhën, leximin dhe motivimin e nxënësve. Teksti i plotë do të jetë i aksesueshëm në faqen e gazetës.

Sonila Shehu

Flora Çollaku

FLORA ÇOLLAKU

1. JEMI NË MUAJIN TETOR, PRA MUAJI I LETËRSISË DHE SI GJITHMONË ERDHE PËRSËRI ME NJË PROJEKT GJIGAND DHE SUPER TË BUKUR. ÇFARË DO TË THOTË KY MUAJ PËR TY?
TETORI PËR MUA ËSHTË SI NJË FESTË SHPIRTËRORE. ËSHTË MUAJI KUR FJALA MERR JETË, KUR LETËRSIA NA BASHKON DHE NA KUJTON SA E BUKUR ËSHTË GJUHA SHQIPE. PËR MUA, KY MUAJ ËSHTË NJË FRYMËZIM PËR TË KRIJUAR, PËR TË LEXUAR MË SHUMË DHE PËR TË AFRUAR NXËNËSIT ME BOTËN MAGJIKE TË FJALËS ARTISTIKE.

2. ÇFARË JU KA SHTYRË TË ZGJIDHNI PROFESIONIN E MËSUESES SË GJUHËS SHQIPE? A ISHTE ËNDRRA JUAJ E FËMIJËRISË APO DIÇKA E IMPONUAR NGA DIKUSH?
KA QENË GJITHMONË ËNDRRA IME. QË E VOGËL KAM DASHUR LIBRAT, LEXIMIN DHE MËNYRËN SI FJALËT MUND TË PREKIN SHPIRTIN. ASKUSH NUK MA IMPONOI KËTË RRUGË — PËRKUNDRAZI, E NDJEVA SI THIRRJE TË ZEMRËS. MËSUESIA PËR MUA NUK ËSHTË THJESHT PROFESION, POR MISION.

3. NGA ANA PROFESIONALE JU PËRSHKRUAJNË SI NJË PERSON ME KARAKTER TË FORTË, POR EDHE TË DASHUR NË TË NJËJTËN KOHË. PSE MENDONI QË ËSHTË KRIJUAR KY OPINION PËR JU?
NDOSHTA SEPSE GJITHMONË PËRPIQEM TË RUAJ EKUILIBRIN MES RREGULLIT DHE DASHURISË. BESOJ SE MËSUESI DUHET TË JETË I DREJTË DHE I QËNDRUESHËM, POR MBI TË GJITHA NJERËZOR. NXËNËSIT E NDIEJNË KUR E BËN PUNËN ME ZEMËR, DHE KJO KRIJON RESPEKT E BESIM RECIPROK.
4. ZYSH FLORA, JU KENI SHUMË VITE QË PUNONI NË SHKOLLËN" TURGUT OZAL." CILA ËSHTË GJËJA MË E VLEFSHME QË KENI MËSUAR GJATË GJITHË KËTIJ RRUGËTIMI SI MËSUESE?
KAM MËSUAR SE ÇDO BREZ ËSHTË NDRYSHE DHE ÇDO NXËNËS ËSHTË NJË UNIVERS MË VETE. KAM MËSUAR TË DËGJOJ MË SHUMË, TË PËRSHTATEM, DHE TË VLERËSOJ ÇDO PËRPJEKJE SADO E VOGËL. NXËNËSIT MË KANË MËSUAR PO AQ SA UNË ATYRE.

5. SI ARRINI TË MBANI GJALLË DASHURINË PËR GJUHËN SHQIPE NË NJË KOHË KUR TEKNOLOGJIA DHE GJUHA E RRJETEVE PO NDIKON SHUMË TEK MËNYRA E KOMUNIKIMIT?
DUKE E BËRË GJUHËN TËRHEQËSE DHE TË GJALLË. PËRDOR AKTIVITETE KREATIVE, LIDH LEXIMIN ME JETËN E PËRDITSHME, DHE MUNDOHEM T'U TREGOJ NXËNËSVE SE GJUHA SHQIPE NUK ËSHTË DIÇKA E VJETËR — ËSHTË PASURI E PËRJETSHME QË NA JEP IDENTITET.

6. A KA PASUR NDONJË NXËNËS QË JU KA BEFASUAR ME TALENTIN APO PËRKUSHTIMIN E TIJ NDAJ LËNDËS SUAJ? MUND TË NDANI NJË RAST QË JU KA MBETUR AKOMA DHE SOT NË MENDJE?

PO, SHUMË HERË. KAM PASUR NXËNËS QË ME SHKRIMET E TYRE MË KANË PREKUR THELLË, QË MË KANË BËRË TË MENDOJ SE LETËRSIA KA TË ARDHME TË NDRITUR. GJITHASHTU MË KUJTOHEN SHPESH NXËNËSIT ,QË EDHE PSE KANË MBARUAR ,MË KUJTOJNË ENDE ME MESAZHET,QË MË DËRGOJNË HERË PAS HERE.

7. SI KA LINDUR IDEJA E KLUBIT TË ARTIT?

IDEJA LINDI NGA DËSHIRA PËR TË KRIJUAR NJË HAPËSIRË KU NXËNËSIT TË MUND TË SHPREHNIN VETEN LIRSHËM, PËRTEJ MUREVE TË KLASËS. ARTI NA BASHKON, NA BËN MË TË NDJESHËM DHE MË KRIJUES, PRANDAJ DOJA QË SHKOLLA TË KISHTE NJË VEND, KU KY SHPIRT ARTISTIK TË MERRTE FRYMË.

8. SI REAGONI KUR NJË PLAN QË KENI PËRGATITUR ME KUJDES NUK SHKON SIÇ E PRISNIT?

E MARR SI NJË MUNDËSI PËR TË MËSUAR. NUK KA PLAN TË DËSHTUAR NËSE E PËRDOR PËR T'U PËRMIRËSUAR. FLEKSIBILITETI ËSHTË ÇELËSI , NDONJËHERË MOMENTET E PAPRITURA SJELLIN REZULTATET MË TË BUKURA.

9. CILA ËSHTË GJËJA MË E ÇUDITSHME QË KENI DËGJUAR PËR VETEN?

KAM DËGJUAR QË "NUK LODHEM KURRË"! (QESH) E VËRTETA ËSHTË SE LODHEM, POR DASHURIA PËR ATË QË BËJ MË RIKTHEN GJITHMONË ENERGJINË.

10. EDHE PSE JENI NË MOSHË TË PJEKUR, GJITHMONË JU SHOHIM PLOT ENERGJI, STIL DHE ELEGANCË. SI ARRINI TA MBANI KËTË SHPIRT RINOR QË JU KARAKTERIZON?

SEKRETI ËSHTË DASHURIA PËR JETËN. PËRPIQEM TË SHOH BUKURINË NË ÇDO DITË, TË RRI AFËR TË RINJVE, TË DËGJOJ MUZIKË, TË LEXOJ DHE TË ËNDËRROJ SI NË RINI. ENERGJIA VJEN NGA BRENDA, NGA GËZIMI QË NDIEN KUR BËN ATË QË DO.

11. DIMË QË JENI NJË NËNË SHUMË E PËRKUSHTUAR, GJITHASHTU NËNË E NJË DJALI ARTIST, PRA KLINTI ÇOLLAKUT. CILI KA QENË POZICIONI JUAJ NË KARRIERËN E TIJ? A MUND TA NDANI ME NE?

KAM QENË DHE JAM MBËSHTETJA E TIJ MË E MADHE, POR GJITHMONË E KAM LËNË TË ZGJEDHË VETË RRUGËN E TIJ. E KAM INKURAJUAR TË NDJEKË PASIONIN DHE T'I BESOJË VETES, SEPSE ARTI KËRKON GUXIM. JAM KRENARE PËR ÇDO HAP QË KA HEDHUR ME PUNË E PËRKUSHTIM.

12. SI DO E PËRSHKRUANIT VETEN ME DISA FJALË?

E PËRKUSHTUAR, KRIJUESE, E NDJESHME DHE ME SHPIRT POZITIV. NJË NJERI QË BESON TE FJALA DHE TE DASHURIA PËR DIJEN.

13. CILI ËSHTË MESAZHI QË PËRPIQENI T'U PËRCILLNI NXËNËSVE TUAJ PËR JETËN DHE SUKSESIN?

T'U BESOJNË ËNDRRAVE, TË MOS DORËZOHEN PËRBALLË VËSHTIRËSIVE DHE TË PUNOJNË ME PASION. SUKSESI NUK VJEN RASTËSISHT ,VJEN KUR I QËNDRON VETES BESNIK DHE ECËN ME NDERSHMËRI E DASHURI PËR ATË QË BËN.

YJET NË FOKUS

Këtë muaj, gazeta jonë pati nderin të zhvillojë një intervistë me Arbër Hajdarin, një nga figurat më të rëndësishme të angazhimit social në Shqipëri. I lindur më 16 shkurt 1994 në Tiranë, Hajdari është themeluesi dhe drejtuesi ekzekutiv i organizatës humanitare "Fundjavë Ndryshe", një nismë që prej vitit 2015 ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në jetën e mijëra familjeve në nevojë.
Organizata e tij ka shtrirje të gjerë sociale, duke u fokusuar në arsim, shëndetësi, strehim, punësim dhe mbështetje emergjente, ndërsa vullnetarët që ka afruar formojnë një rrjet të fuqishëm solidariteti në shumë qytete të vendit. Rruga e tij nisi nga një gjest i thjeshtë , blerja e ushqimeve për një familje në vështirësi , që shpejt u kthye në një mision jetësor për të ndihmuar njerëzit që nuk kanë zë.

Në intervistën tonë me 5 pyetje kryesore, Hajdari ndau mendimet e tij mbi sfidat e punës humanitare, rëndësinë e vullnetarizmit dhe nevojën që të rinjtë të jenë më të angazhuar në komunitet. Ai foli për motivimin personal, historitë më prekëse që ka hasur gjatë këtyre viteve dhe filozofinë e tij: "mirësia nuk ka nevojë për reklamë, por ka nevojë për veprim."
Arbër Hajdari është vlerësuar me tituj "Qytetar Nderi" në disa qytete shqiptare për punën e tij të palodhur, ndërsa vazhdon të jetë aktiv në media e në rrjete sociale për të rritur ndërgjegjësimin publik. Edhe pse shpesh përballet me debate dhe kritika , si çdo figurë publike , ai mbetet ndër zërat më të qëndrueshëm në fushën e bamirësisë dhe një shembull inspirimi për shumë të rinj.

Kjo intervistë sjell një portret të sinqertë dhe të thellë të një njeriu që punon çdo ditë për të sjellë ndryshim real në jetët e njerëzve. Lexuesit tanë do të gjejnë mesazhe motivuese, reflektime të fuqishme dhe një shembull konkret se si një individ mund të ndikojë pozitivisht në një shoqëri të tërë.

KËNDI KREATIV

MUAJI I SHQIPËRISË 28-29 NËNTORI

Zbukurimet Historike

Në kuadër të festave të 28–29 Nëntorit dhe muajit të Historisë & Gjeografisë, nxënësit kanë krijuar një atmosferë të veçantë festive në shkollë. Ata kanë sjellë postera me figura historike të famshme, citate frymëzuese dhe ilustrime artistike që rikujtojnë momentet më të rëndësishme të historisë sonë.

Art, Dekor & Kreativitet

Atmosfera festive është plotësuar me dekorime artistike që nxënësit kanë punuar me përkushtim. Përveç pikturave dhe vizatimeve tematike, janë vendosur flamuj kuqezi, tullumbace dhe skulptura të vogla, duke e kthyer shkollën në një hapësirë të gjallë e plot simbolikë kombëtare.

Traditë, Kulturë & Trashëgimi Kombëtare

Nxënësit kanë sjellë libra historikë, sende tradicionale dhe veshje popullore që përfaqësojnë kulturën shqiptare. Punimet artizanale dhe objektet simbolike kanë krijuar një mini-ekspozitë që e lidh traditën me kreativitetin e brezit të ri. Këto kanë sjellë në shkollë atmosferën e vlerave dhe rrënjëve tona kombëtare.

www.reallygreatsite.com

PIKTURA *dhe* POEZI

Kjo është nje pikturë dhe një poezi e shkruar nga nxënësi Noels Likollari e 11-G

Heroina e Heshtur

Ah, sa dua, moj nëna ime,
Të shkëlqej për ty më shumë.
Të jetë jeta jote gur diamanti,
Të të shkëlqejë mbi çdo rrudhë.

Se ato rrudhat e tua të shtrenjta
Janë thesare dije për mua.
Janë manual sjelljeje dhe këshilla,
Janë udha që ti më ke treguar.

Ah, sa shumë dua, moj nëna ime,
Që një ditë, jo larg nga sot,
Të të dëgjoj përsëri të më thuash:
“Ti je krenaria më e madhe në botë.

Ah, sa shumë gjëra për ty unë dua,
Kam dëshira pa mbarim.
Se ti je heroina e heshtur për mua,
Ti je shpirti i shpirtit tim.

Seç më priste sot te porta,
Pranë shtëpisë që më rriti,
Plot me ledha, fjalë të ngrohta,
Nëna ime, grahmë shpirti.

Sot jam rritur, kështu them unë,
Sepse ti “i vogli i nënës” më thua.
Sado vitet të kalojnë,
Ti i vogël je për mua.

Sa mall kam për ty, moj nënë,
Të të kem pranë dua çdo ditë.
Të dëgjoj çdo fjalë me ëndje,
Goja jote nxjerr veç dritë.

Sa shumë dua pranë të të kem,
Dhe kur ndonjëherë më kap mërzia,
Je për mua oaz paqeje,
Veç te ti më kaplon qetësia.

Dhe kur zemra flakë më lëshon,
Ti ma shuan me një fjalë.
Je e vetmja që më çkodon,
Çelësin e universit për mua ti e mban.

Flokët e bardha, ngjyrë argjendi,
Përmbi supe fytyrën ta mbulojnë.
Këshillat e tua në zemër i kam gdhendur,
Dhe gjithë jetën do më udhëzojnë.

Je për mua, ti moj nënë,
Porsi ajri lart në hënë.
Ti për mua, o nënë e mirë,
Je si ujë në shkretëtirë.

Fjalë pak e gojë mjaltë,
Më je ti, o nëna ime.
Jam me fat që më ke rritur,
Të jam falë për të gjitha ato mundime.

Kur ti mua më tregon
Si je kujdesur për mua,
Dua shumë që një ditë
Të jem krahë për duart e tua.

Ah, sa dua që një ditë
Të krenohesh edhe ti me mua.
Ah, sa dua që një ditë
Të të ndritin sytë ashtu si për ty mua.

PIKTURA

Nën Dritën e Dijes

“Kjo pikturë pasqyron thellësinë shpirtërore dhe qetësinë intelektuale të një njeriu të zhytur në lexim. Nën dritën e ngrohtë të një lampe, figura qendrore përkullet mbi faqet e librit, duke shprehur përqendrim, reflektim dhe respekt për dijen. Ngjyrat e buta dhe kompozimi harmonik tërheqin vëmendjen te atmosfera e qetë e bibliotekës, e cila simbolizon botën e pafund të ideve. Raftet e mbushura me libra krijojnë ndjesinë e një hapësire ku arti dhe letërsia bashkëjetojnë në mënyrë organike, duke i dhënë veprës një karakter meditativ. Piktura jo vetëm nderon muajin e artit dhe letërsisë, por edhe rikujton fuqinë që ka leximi për të ndriçuar mendjen dhe për të ushqyer shpirtin.”



Kjo është nje pikturë nga nxënësi Qamil Xheka e 11-G

TOP PICKS TË MUAJIT

"Në këto zgjedhje të muajit kemi përzgjedhur serialin dhe librin që nuk duhen humbur — mister, emocione dhe histori që të mbajnë me frymë."
vlejnë çdo minute!"



Pse duhet ta lexosh Katedralen e Parisit?
Sepse është shumë më tepër se një histori dashurie. Te Quasimodo dhe Esmeralda sheh se bukuria e vërtetë s'është në pamje, por në shpirt. Romani të fut në Parisin e lashtë, plot mister dhe ndjenja, dhe të kujton që ndonjëherë zemrat më të mira fshihen pas pamjeve më të çuditshme. Një klasik që s'harrohet lehtë!
Në çdo faqe ndien tragjedinë, bukurinë dhe forcën e dashurisë që sfidon gjithçka. Lexoje, dhe do kuptosh pse kjo histori vazhdon të mbetet e pavdekshme.

Seriali i muajit — Stranger Things
Pas viteve plot mister, aventura dhe përbindësha nga "Upside Down", "Stranger Things" po i afrohet fundit!
Sezoni i pestë do të jetë sezoni mbyllës, dhe fansat në mbarë botën mezi po presin të shohin si do mbyllet historia e Eleven dhe miqve të saj.
Ky serial është një përzierje perfekte mes nostalgjisë së viteve '80, miqësisë, frikës dhe fantazisë. Çdo episod të mban me frymë dhe të kujton pse ky është një nga serialet më të dashura të Netflix-it.
Nëse s'e ke parë ende, tani është koha ideale për ta nisur — fundi po afron, dhe do të jetë epik!

A E DINIT SE...

OKSFORDI KA NJË SHKOLLË VERORE

...disa nga nxënësit tanë më të angazhuar dhe më të dalluar përzgjidhen çdo vit për të marrë pjesë në Shkollën Verore të Oksfordit?
Ata kalojnë dy javë në kampuset historike të Oksfordit, ndjekin kurse të avancuara në fusha si letërsi, shkencë, ekonomi e art, dhe përjetojnë jetën akademike britanike nga afër.
Një eksperiencë që u hap horizonte të reja dhe i kthen më të motivuar se kurrë!

Kjo është një aventurë që kombinon mësimin, kulturën dhe argëtimin, një përvojë që mbetet gjatë në kujtesë.

Kronika Sportive



Shqipëri – Angli: Përfundoi fushata e kualifikimeve

Kombëtarja shqiptare u përball me Anglinë sot në "Arena Kombëtare" në ndeshjen e fundit të fazës së grupeve për Botërorin 2026.

Anglia fitoi 2-0, falë dy golave të kapitenit Harry Kane, që i vulosi "Luaneve" një fushatë pa asnjë humbje.

Megjithatë, Shqipëria tregoi rezistencë dhe organizim dhe kjo ndeshje përfundon një kapitull me mësime dhe përvojë që do t'i shërbejnë për aventurat e ardhshme.

Këshilla Sportive për Nxënësit

- Bëj nxehje para çdo aktiviteti, që të shmangësh dëmtimet.
- Pi shumë ujë gjatë ditës.
- Ha ushqime që të japin energji: fruta, proteina, kos.
- Mos e tepro me ushtrime, bëji saktë, jo shumë.
- Fli mjaftueshëm që trupi të rikuperohet.
- Bëj shtriqje pas stërvitjes që muskujt të mos ngurtësohen.
- Mbaji gjithmonë pajisjet sportive të pastra dhe në gjendje të mirë.

Këndi i të qeshurit

Në shkollën tonë ndodh gjithçka. Disa vijnë për të mësuar, disa për të harruar detyrat, e disa vetëm për të pyetur nëse ka munguar mësuesja. Thonë se arsimi është dritë, por kur bien dritat në orën e matematikës, të gjithë ndihen më të ndriçuar se kurrë.

Gjatë pushimit të madh, oborri gumëzhin nga zërat dhe të qeshurat. Dikush ndan byrekun me shokun dhe dikush tregon histori "epike" nga orët e mësimit.

Në fund të ditës, të gjithë premtojnë se do të mësojnë "nga nesër". Por çdo ditë në shkollë mbetet një aventurë plot humor dhe kujtime që do të na bëjnë të qeshim për vite me radhë.

Në klasën tonë ndodh një mrekulli çdo ditë: sapo mësuesja hap ditarin, kujtesa e të gjithëve fiket menjëherë. Askush nuk e di ku janë detyrat, por të gjithë e dinë në cilën bankë ka karamele. Disa pretendojnë se mendojnë "thellë", por në fakt po llogarisin sa minuta kanë mbetur deri në pushim. Kur bie zilja, shpejtësia me të cilën nxënësit dalin nga klasa është aq e madhe, sa fizikisht duhet të ketë një ligj për këtë.

FJALËKRYQ

HORIZONTALE

1. ajo e shqipërisë ka shqipen me dy krerë
6. ... *culpa* e pranoi dhe Saliu... për piramidat
9. Kryeqyteti i Boliviës
10. ka mbaruar studimet për inxhinjeri
11. kështu fillon Mamurrasi
12. futbollisti më i njohur gjerman tek ne
13. Franc, autori i Proçesit
15. koleg me Masën tek Ferrari
19. emri i autorit të *Rubaitrave*
20. e kundërta e Off
21. Emri i modeles së quajtur *perla nera*
23. Po... në gjermanisht
24. shkurtim për *street* o për *strasse*
25. Dy... për hispanikët
26. shiko foton në skemë
30. Nur, bukuri
31. Gërma e parë e alfabetit grek
32. *trade mark*
33. E ndërtojmë për të lidhur dy brigjet
35. Skuadër e shkodrës
36. Ai i biçikletës buk është si i makinës
38. Sigla e Maqedonisë
39. Problemet që do zgjidhim me TEC me qymyr
42. kështu fillon rinia e risia
43. burim i rinovueshëm energjie
44. njësia matëse e rezistencës
45. e kundërta e *down*
47. në targat shqipëtare
48. Më parë se të quhej Shqipëri...

VERTIKALE

1. Sulo dhe Sali i kanë të njëjta
2. Fiks fare, ose ...
3. kështu deklarohet ajo, kur nuk ka bërë faj
4. e përsëritur dy herë, është sinonim i nënës
5. shkakton probleme në frymëmarrje
6. mund të fitojë gjithçka në botë, por ka humbur në Tiranë
7. ndërmarrja më e njohur italiane e energjisë
8. drejtuesi më i "papolitizuar" i RTSH
13. ka monitor, tastierë e sistem operativ...
14. Lokale, por shumë më e gjerë se fshati dhe qyteti
16. targa e Napolit
17. përdoret për të larë dhe për të gatuar
18. ...*fobia*, frika ndaj atyre që seksualisht e mendojnë ndryshe nga ne
20. Sigla me të cilën njihet OKB në botë
22. Kështu quhen banorët e Ishmit
24. një emër tjetër për kastravecin
27. Kruja
28. sistem transmetimi televiziv
29. mallkim i mbetur nga turqishtja në gjuhën tonë
32. I bën konkurrencë Vodafonit
34. Kështu quhej parku i Taivanit
35. bashkësi e pikave të vëna njëra pas tjetrës...
37. spostoj pak më lart, ose...
40. bimba pa krahët
41. gjysma tek europa
46. e shumëzuar me diametrin, jep perimetrin.....

Fjalëkryqe

GJEJ FJALËT E FSHEHURA

G	B	A	L	L	K	O	N	N	P	A	J
F	A	S	A	D	E	Z	X	E	A	P	Y
D	Q	A	S	H	E	N	S	O	R	A	H
T	P	J	V	X	T	N	K	I	K	R	A
T	H	M	D	E	N	E	P	C	I	T	M
T	W	R	K	O	R	E	N	A	M	A	O
Y	Z	R	L	Y	T	A	D	O	N	M	H
M	A	L	K	H	L	W	N	X	Z	E	D
P	A	V	S	Q	G	G	J	D	W	N	Q
S	I	P	L	L	A	K	A	T	E	T	H
K	O	N	D	I	C	I	O	N	I	M	K
X	K	I	N	V	E	S	T	I	M	C	C

OUR MAGAZINE AT YOUR HANDS

KËTU DO TE GJENI KANALIN E YOUTUBE-IT TONË

https://www.youtube.com/@turgutozal highschooltirana

KËTU DO TE GJENI WEBSITE-TIN TONË

https://highschool.turgutozal.edu.al

Në nder te stafit tonë

Sonila Shehu
Rajmonda Haxhiaj
Ola Xhaferaj
Diljon Duriçi-11G
Erka Reçi-11G
Anda Çeka-11G
Bora Cana-11G
Herika Oruçi-11G
Erjona Kovaçi-11G
Ervis Duriçi-11F
Jasemina Ahmati-12A